



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.969/9 prot.

Datë 16.04.2026

**V E N D I M**

**Nr. 509/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.04.2026 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), mbi pretendimet e pranuar plotësisht të paraqitura nga operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Shpk, për procedurën e prokurimit “*E hapur - mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-70301-11-26-2025, me objekt “*Projektim i objektit “Linje e re Transmetim Boville – Pika 0 me tub çeliku D=700mm; L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville*”, me fond limit 53,414,672.00 (pesedhete e tre milion e katerqind e katermbedhete mije e gjashteqind e shtatedhete e dy) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetës Kanalizime Kamëz Sh.a.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Shpk, në procedurën e prokurimit sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “InfraKonsult” Shpk (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, në procedurën e prokurimit sipërcituar.

**Ankimues:**

BOE “InfraKonsult” Shpk (përfaqësues) me NUIS L21512022F me adresa: Njesia Bashkiake nr.8, rruga "Qemal Stafa", shkalla 1, kati 0, perballe Qendres Lincoln, ZK 8370, nr pasurie 9/, Tiranë & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk.

**Autoriteti Kontraktor:**

Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.a me adresë: Lagja 1, Rruga Tregtare, Durrës

**Subjekt i interesuar:**

Operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Shpk me NIPT K91810005U dhe adresë: Njesia Administrative Nr. 05, Rruga Sami Frasheri, Pallati Nr. 45, Shkalla 01, Kati i pare, Zona Kad, Tiranë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

**I**

## *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lart monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## **II**

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 27.11.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-70301-11-26-2025, me objekt “Projektim i objektit “Linje e re Transmetim Boville – Pika 0 me tub çeliku D=700mm; L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville”, me fond limit 53,414,672.00 (pesedhjetë e tre milion e katerqind e katermbedhjetë mijë e gjashtëqind e shtatedhjetë e dy) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.a.

II.2. Në datën 29.12.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 20.01.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- |   |               |                |
|---|---------------|----------------|
| 1. INSTITUTI DEKLIADA-ALB shpk  | 48,073,205    | I skualifikuar |
| 2. BOE GRAMA shpk & ZENIT & CO shpk   | 48,073,205.28 | I skualifikuar |
| 3. BOE InfraKonsult shpk<br>& “ARABEL” SHPK<br>& “Transport Highëay Consulting” SHPK<br>& “Civil Cons” Shpk | 48,100,000    | I kualifikuar  |
| 4. GJEOKONSULT & CO shpk  | 52,346,378    | I skualifikuar |

II.4. Në datën 28.01.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim -Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku fitues është shpallur BOE “InfraKonsult shpk” & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 10 datë 02.02.2026.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi nr. A/2026/6303, si dhe nr. protokollit 336/2026 datë 03.02.2026 e operatorit ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Shpk, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk.

II.5.1. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 336/1 prot., datë 04.02.2026, lidhur me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk.

II.5.2. Me shkresën nr. 336/2 prot., datë 09.02.2026, të protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, subjekti i interesuar BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, ka dërguar një shkresë me objekt: “Vënie në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik dhe Autoriteti Kontraktor”.

II.5.3. Në datë 02.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.318/2026, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. Nr. REF-70301-11-26-2025, me objekt “Projektim i objektit “Linje e re Transmetim Boville – Pika 0 me tub çeliku D=700mm; L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville”, me fond limit 53,414,672.00 (pesedhjetë e tre milion e katerqind e katermbedhjetë mijë e gjashteqind e shtatedhjetë e dy) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Kamëz Sh.a.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e paraqitur nga BOE “InfraKonsult” SHPK & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk,

në zbatim të Vendimit të KSHA-së me nr. 124/5 prot., datë 24.02.2026, duke e skualifikuar këtë BOE.

3. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK, duke e kualifikuar atë në zbatim të vendimit të KSHA.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.5.4. Me shkresën nr. 469/1 prot., datë 09.03.2026, protokolluar me tonën nr. 336/10 prot., datë 11.03.2026, autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.a., njofton se, ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 318/2026, datë 02.03.2026, si vijon: “.....Në zbatim të vendimit nr.318/2026 datë 02.03.2026, të KPP\_së, lidhur me procedurën e prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. Nr. REF-70301-11-26-2025, me objekt "Projektim i objektit “Linje e re Transmetim Boville – Pika 0 me tub çeliku D=700mm; L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville”, me fond limit 53,414,672.00 lekë pa Tvsh, ju informojmë se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr.318/2026, datë 02.03.2026 të KPP-së. Veprimet përkatëse janë reflektuar në përputhje me përcaktimet e bëra në vendimin e KPP\_së dhe në sistemin elektronik të prokurimit publik., - procesverbali i rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 469/2 prot., datë 09.03.2026;

II.5.5. Nga verifikimi i kryer në sistemin e prokurimit elektronik, si dhe nga informacioni i autoritetit kontraktor rezultoi se në datën 09.03.2026, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “GJEOKONSULT & CO” SHPK dhe “BOE “InfraKonsult” SHPK & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk,” në zbatim të vendimit Nr. 318/2026, datë 02.03.2026 të KPP, përkatësisht:

1. INSTITUTI DEKLIADA-ALB shpk 48,073,205 I skualifikuar
2. BOE GRAMA shpk & ZENIT & CO shpk 48,073,205.28 I skualifikuar
3. BOE InfraKonsult shpk

& “ARABEL” SHPK

& “Transport Highëay Consulting” SHPK

& “Civil Cons” Shpk 48,100,000 I skualifikuar

4. GJEOKONSULT & CO shpk 52,346,378 I kualifikuar

II.5.6. Në datë 12.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.393/2026, ku vendosi:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. Nr. REF-70301-11-26-2025,

*me objekt "Projektim i objektit "Linje e re Transmetim Boville – Pika 0 me tub çeliku D=700mm; L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville", me fond limit 53,414,672.00 (pesedhjetë e tre milion e katerqind e katermbedhjetë mijë e gjashtëqind e shtatedhjetë e dy) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.a.*

*2. Kopje e këtij vendimi I dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

II.5.7. Në datën 26.03.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE "Formular Njoftim - Fituesi Paraprak", për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku fitues është shpallur operatori ekonomik "GJEOKONSULT & CO" SHPK.

II.6. Në datën 05.03.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6390, me nr. protokollit 716/2026 datë 05.03.2026, e cila figuron me statusin e pa paguar si dhe ankimi elektronik me nr. A/2026/6391, me nr. protokollit 716/1/2026 datë 05.03.2026, e BOE "InfraKonsult" Shpk (përfaqësues) & "ARABEL" SHPK & "Transport Highëay Consulting" SHPK & "Civil Cons" Shpk, **ku janë të njëjtat pretendime si në formular ankese me numër ankimi elektronik A/2026/6390**, me statusin e paguar mandat pagesa për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimi e vendimmarrjes së Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "GJEOKONSULT & CO" Shpk, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE "InfraKonsult" SHPK (përfaqësues) & "ARABEL" SHPK & "Transport Highëay Consulting" SHPK & "Civil Cons" Shpk, i cili nuk përmbush kriteret e vendosura për kualifikim sipas kriterëve të kualifikimit të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 716/2 prot., datë 05.03.2026.

II.6.2. Më datë 13.03.2026, nëpërmjet shërbimit postar, BOE "InfraKonsult" SHPK (përfaqësues) & "ARABEL" SHPK & "Transport Highëay Consulting" SHPK & "Civil Cons" Shpk, ka dërguar materialin shtesë ankese, protokolluar me tonën me nr. 716/3 prot., datë 13.03.2026.

II.6.3. Me shkresën me nr .716/4 prot., datë 24.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik, i është drejtuar me shkresë autoritetit kontraktor, të dërgoi informacion mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, në përmbushje të nënit 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti kontraktor ose enti kontraktor” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

II.6.4. Nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën përcjellëse me nr. 655/1 prot, datë 27.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 716/5 prot., datë 30.03.2026, me objekt: “Dërgim informacioni”.

II.6.5 Në datë 31.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.448/2026, ku vendosi:

1. *Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “InfraKonsult” Shpk (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, në procedurën e prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. Nr. REF-70301-11-26-2025, me objekt "Projektim i objektit “Linje e re Transmetim Boville – Pika 0 me tub çeliku D=700mm; L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville”, me fond limit 53,414,672.00 (pesedhete e tre milion e katerqind e katermbedhete mije e gjashteqind e shtatedhete e dy) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetës Kanalizime Kamëz Sh.a.*
2. *Autoriteti kontraktor nuk mund të lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, deri në shqyrtimin e plotë të formularit të ankesës së BOE “InfraKonsult” Shpk (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk me nr. Ankimimi elektronik A/2026/6465 me nr. 969 Prot., me datë 31.03.2026.*
3. *Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga BOE “InfraKonsult” Shpk (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk.*
4. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
5. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*  
*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

II.7 Në datën 31.03.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6465, me nr. protokoll 969/2026 datë 31.03.2026, e BOE “InfraKonsult” Shpk (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimi e vendimmarrjes së Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, mbi pretendimet e pranuar plotësisht të paraqitura nga operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Shpk. si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons”

Shpk, i cili nuk përmbush kriteret e vendosura për kualifikim sipas kriterëve të kualifikimit të bërë nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit të sipërcituar. Gjithashtu, u konstatua se objekti i ankesës lidhet edhe me kundërshtimi e vendimmarrjes së Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Shpk. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik publikon pretendimet e BOE ankmiues për mospërmbushjen e kriterëve nga operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Shpk

II.7.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 969/1 prot., datë 01.04.2026.

II.7.2. Nëpërmjet sistemit elektronik, autoriteti kontraktor “Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.a” ka dërguar informacion mbi trajtimin e formularit të ankesës së ankimuesit, “Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Akeseve” me nr. 740 prot, datë 02.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 969/2 prot., datë 07.04.2026.

II.7.3. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor “Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.a” ka dërguar informacion mbi trajtimin e formularit të ankesës së ankimuesit, me shkresën përcjellëse me nr. 740/2 prot., datë 03.04.2026 me lëndë: “Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Akeseve”, Vendimi me nr. 740 prot, datë 02.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 969/3 prot., datë 07.04.2026.

II.7.4 Me shkresën me datë 08.04.2026, nëpërmjet postës elektronike, BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, ka dërguar shkresën me objekt “Kërkesë”, për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik, protokolluar me tonën me nr. 969/4 prot., datë 09.04.2026.

II.7.5 Nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën me datë 08.04.2026, BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, ka dërguar shkresën me objekt “Kërkesë”, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, protokolluar me tonën me nr. 969/5 prot., datë 09.04.2026.

II.7.6. Nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën me datë 08.04.2026, BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, ka dërguar shkresën me objekt “Kërkesë për sqarim mbi legjitimitetin e ankimimit të “Gjeokonsult & Co” Shpk dhe mospërputhjet në trajtimin procedural të palëve në procedurën e

prokurimit nr. REF-70301-11-26-2025”, drejtuar autoritetit kontraktor, për dijeni Komisionit të Prokurimit Publik, protokolluar me tonën me nr. 969/6 prot., datë 09.04.2026.

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, i ndryshuar, në sistemin e ankesave elektronike.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk mbi skualifikimin e padrejtë të ofertës së tij ekonomike nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) dhe kualifikimin e e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Shpk në procedurën e mësipërme të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në datën 27.11.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-70301-11-26-2025, me objekt “Projektim i objektit “Linje e re Transmetim Boville – Pika 0 me tub çeliku D=700mm; L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville”, me fond limit 53,414,672.00 (pesedhjetë e tre milion e katerqind e katermbedhjetë mijë e gjashtëqind e shtatedhjetë e dy) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Kamëz Sh.a.

III.1.2 Në datën 29.12.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

III.1.3. Në datën 20.01.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- |   |               |                |
|---|---------------|----------------|
| 5. INSTITUTI DEKLIADA-ALB shpk  | 48,073,205    | I skualifikuar |
| 6. BOE GRAMA shpk & ZENIT & CO shpk   | 48,073,205.28 | I skualifikuar |
| 7. BOE InfraKonsult shpk<br>& “ARABEL” SHPK<br>& “Transport Highëay Consulting” SHPK<br>& “Civil Cons” Shpk | 48,100,000    | I kualifikuar  |

III.1.4. Në datën 28.01.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim - Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku fitues është shpallur BOE “InfraKonsult shpk” & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 10 datë 02.02.2026.

III.1.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi nr. A/2026/6303, si dhe nr. protokollit 336/2026 datë 03.02.2026 e operatorit ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Shpk, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

**Nga shqyrtimi i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk.**

III.1.5.1. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 336/1 prot., datë 04.02.2026, lidhur me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk.

**III.1.5.2. Nëpërmjet shërbimit postar me shkresën nr. 336/2 prot., datë 09.02.2026, të protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, subjekti i interesuar BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, ka dërguar një shkresë me objekt: “Vënie në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik dhe Autoriteti Kontraktor”.**

III.1.5.3. Në datë 02.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.318/2026, ku vendosi:

8. *Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. Nr. REF-70301-11-26-2025, me objekt "Projektim i objektit “Linje e re Transmetim Boville – Pika 0 me tub çeliku D=700mm; L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville”, me fond limit 53,414,672.00 (pesedhete e tre milion e*

katerqind e katermbedhjte mije e gjashteqind e shtatedhjte e dy) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.a.

9. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e paraqitur nga BOE “InfraKonsult” SHPK & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, në zbatim të Vendimit të KSHA-së me nr. 124/5 prot., datë 24.02.2026, duke e skualifikuar këtë BOE.
10. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK, duke e kualifikuar atë në zbatim të vendimit të KSHA.
11. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
12. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK.
13. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
14. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

III.1.5.4. Me shkresën nr. 469/1 prot., datë 09.03.2026, protokolluar me tonën nr. 336/10 prot., datë 11.03.2026, autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.a., njofton se, ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 318/2026, datë 02.03.2026, si vijon: “.....Në zbatim të vendimit nr.318/2026 datë 02.03.2026, të KPP\_së, lidhur me procedurën e prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. Nr. REF-70301-11-26-2025, me objekt "Projektim i objektit “Linje e re Transmetim Boville – Pika 0 me tub çeliku D=700mm; L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville”, me fond limit 53,414,672.00 lekë pa Tvsh, ju informojmë se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin Nr.318/2026, datë 02.03.2026 të KPP-së. Veprimet përkatëse janë reflektuar në përputhje me përcaktimet e bëra në vendimin e KPP\_së dhe në sistemin elektronik të prokurimit publik:, - procesverbali i rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 469/2 prot., datë 09.03.2026;

III.1.5.5. Nga verifikimi i kryer në sistemin e prokurimit elektronik, si dhe nga informacioni i autoritetit kontraktor rezultoi se në datën 09.03.2026, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësim të ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “GJEOKONSULT & CO” SHPK dhe “BOE “InfraKonsult” SHPK & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk,” në zbatim të vendimit Nr. 318/2026, datë 02.03.2026 të KPP, përkatësisht:

5. INSTITUTI DEKLIADA-ALB shpk 48,073,205 I skualifikuar
6. BOE GRAMA shpk & ZENIT & CO shpk 48,073,205.28 I skualifikuar
7. BOE InfraKonsult shpk

& “ARABEL” SHPK

& “Transport Highëay Consulting” SHPK

& “Civil Cons” Shpk

48,100,000 I skualifikuar

8. GJEOKONSULT & CO shpk 52,346,378 I kualifikuar

III.1.5.6. Në datë 12.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.393/2026, ku vendosi:

3. *Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-70301-11-26-2025, me objekt “Projektim i objektit “Linje e re Transmetim Boville – Pika 0 me tub çeliku D=700mm; L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville”, me fond limit 53,414,672.00 (pesedhjetë e tre milion e katerqind e katermbedhjetë mijë e gjashtëqind e shtatedhjetë e dy) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.a.*

4. *Kopje e këtij vendimi I dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

III.1.5.7. Në datën 26.03.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim - Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, ku fitues është shpallur operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” SHPK.

III.1.6. Në datën 31.03.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6465, me nr. protokollin 969/2026 datë 31.03.2026, e BOE “InfraKonsult” Shpk (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimi e vendimmarrjes së Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, si dhe me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Shpk. Gjithashtu, operatori ekonomik ankimues ngre pretendime për mospërbushjen e kriterëve nga operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Shpk

III.1.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 969/1 prot., datë 01.04.2026.

III.1.8 Nëpërmjet sistemit elektronik, autoriteti kontraktor “Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.a” ka dërguar informacion mbi trajtimin e formularit të ankesës së ankimuesit, “Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave” me nr. 740 prot, datë 02.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 969/2 prot., datë 07.04.2026. Referuar vendimit të KSHA rezulton se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj.

III.1.9. Vendimin e KSHA me nr. 740 prot, datë 02.04.2026, autoriteti kontraktor e ka përcjellë pranë KPP edhe në [përmjet shërbimit postar, protokolluar me tonën me nr. 969/3 prot., datë 07.04.2026.

III.1.10. Neni 110, pika 1 dhe 2, i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: *“1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit.*

*Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

*2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”*

Neni 111 i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

*“1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.*

*2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.*

*3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paraqitur.*

*4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik”.*

Neni 113 “Të drejtat e operatorëve ekonomikë” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

*“1. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

*Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

*Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë.*

**Paraqitja e argumenteve bëhet në Sistemin e Ankesave Elektronike.**

*2. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi”.*

Neni 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon parashikon shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

*Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.*

*2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalohë 30 ditë. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.*

*3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:*

- a) pranimin e plotë të ankesës;*
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;*
- c) refuzimin e ankesës.*

*4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*

***5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar dhe brenda 10 ditëve për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, sipas pikës 4 të këtij neni.***

*6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

Neni 115, pikat 1 dhe 2 “Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër”.

Neni 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.

2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;

*d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik”.*

III.1.11. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues BOE “InfraKonsult” Shpk (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, si mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Shpk para shqyrtimit në themel të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, Komisioni referuar kronologjisë së fakteve të parashtruara më sipër, si dhe referuar bazës ligjore të sipërcituar gjen me vend të sqarojë dy momente tepër të rëndësishme, si mbi interesin e ligjshëm të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në kuptim të ligjit aktual në fuqi, ashtu edhe të së drejtës së tyre për të ushtruar të drejtën e ankimit për skualifikimin e ofertës së tyre nga veprimet e autoritetit kontraktor dhe për kualifikimin e operatorëve të tjerë ekonomikë në procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

Bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 110 dhe 113 “Të drejtat e operatorëve ekonomik të interesuar”, parashikohet se: “1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë. 2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”. Në nenin 113 parashikohet se: “1. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë. **Paraqitja e argumenteve bëhet në Sistemin e Ankesave Elektronike.** 2. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi.”, çdo person që pretendon se ka interes në një procedure prokurimi, se është dëmtuar ose që rrezikon të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor duhet t’i referohet një shtate konkrete për të provuar cenimin ose shkeljen e një të drejte ose interesi të ligjshëm, interes i cili individualizohet nga elemente konkrete si subjektet (palët) dhe shkaku (e drejta ose marrëdhënia juridike e cenuar që ndodhet në themel të ankesës). Operatori ekonomik ankimues, që rrezikon

të cenohet, duhet të identifikojë faktin që përbën cenimin e të drejtës ose interesit të ligjshëm, si dhe të drejtën që synon të realizojë, e cila duhet të jetë konkrete dhe të ketë lindur para dorëzimit të ankesës.

Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, KPP konstaton, se fillimisht në datën 20.01.2026 autoriteti kontraktor ka vlerësuar ofertat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës dhe më pas në datën 28.01.2026 ka publikuar njoftimin e fituesit për procedurën objekt ankimi. Në datën 03.02.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar me numër ankimi nr. A/2026/6303, si dhe nr. protokoli 336/2026 datë 03.02.2026 e operatorit ekonomik “GJEOKONSULT & CO” Shpk, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE 3 “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit 336/1 prot., datë 04.02.2026.

**Nëpërmjet shërbimit postar me shkresën nr. 336/2 prot., datë 09.02.2026, të protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, subjekti i interesuar BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, ka dërguar një shkresë me objekt: “Vënie në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik dhe Autoriteti Kontraktor”.**

Referuar nenit 113 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku subjektet që mund të cenohen nga ankesa e paraqitur kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me ankesat e operatorëve të tjerë, duke përmbushur 3 kushte kumulative: 1. Të cenohen nga ankesa e paraqitur (në rastin konkret është ankesa e operatorit ekonomik “Gjeokonsult & Co” SHPK) 2. Kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit (ankesën) njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik 3. Argumentet të paraqiten në përputhje me afatet kohore dhe mënyrën e paraqitjes të përcaktuara në nenin 113 të ligjit për prokurimin publik.

Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi. Pra, sistemi i ankimit njih të drejtën e ankimit një herë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoriteteve kontraktore, në rast se operatorët ekonomikë gjykojnë, se për shkak të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor mund të cenohen të drejtat e tyre. Ndërkohë, ligjvënësi ka parashikuar edhe

të drejtat e subjektit të interesuar në procedurën e prokurimit në përputhje me nenin 113 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në nenin 114 të LPP-së, parashikohet shprehimisht, se *“Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës”*. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, për procedurat nën kufirin e lartë monetar kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni. Ndërsa në nenin 100 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pika 4 dhe 5, parashikohet: *“4. Autoriteti/enti kontraktor merr vendim, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 114, të LPP-së, dhe vë në dijeni, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës. 5. Kundër vendimit të autoritetit/entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar dhe brenda 10 ditëve për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, sipas pikës 4, të këtij neni”*.

Referuar materialeve të fashikullit administrativ, procedura objekt ankimi është procedurë mbi kufirin e lartë monetar, subjekti BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, si subjekt që çënohej nga ankesa e operatorit ekonomik “Gjeokonsult & Co” SHPK me nr. 336/2026 prot., datë 03.02.2026, referuar bazës ligjore të sipërcituar ka të drejtë të paraqes argumentet e tij në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik, argumenta të cilat duhet të paraqiten në Sistemin e Ankesave Elektronike. Referuar kronologjisë së fakteve, Komisioni konstaton se argumentet e paraqitura nga operatori ekonomik BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk në datë 09.02.2026 **nëpërmjet shërbimit postar**, janë paraqitur në kundërshtim me parashikimet e nenit 113 pika 1 i ligjit 162/2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, duke mos respektuar kështu rrugën për paraqitjen e tyre.

Komisioni i Prokurimit Publik, thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Gjithashtu, KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me institutin e ankimit administrativ, të rishikimit të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor. Sa më sipër, e drejta procedurale e njohur nga ligji për të paraqitur argumente kundër ankesës së operatorëve ekonomikë nga operatorët e tjerë ekonomikë të interesuar, lidhet ngushtësisht me paraqitjen e argumenteve mbi ankesën e dorëzuar nga këto të fundit në kuadër të rishikimit administrativ. Pra, subjektet e interesuara, në paraqitjen e argumenteve duhet të mbajnë në konsideratë, se e drejta procedurale e paraqitjes së argumenteve është e ndryshme nga e drejta e ankimit, pasi kemi të bëjmë me dy momente të ndryshme. E para, (argumenti) lidhet me faktin e kundështrimit të ankesës (paraqitjes së pretendimeve nga palët, se përse ankesa e paraqitur nuk duhet pranuar nga ana e autoritetit kontraktor/Komisionit të Prokurimit Publik), ndërkohë ankesa në thelb përbën një mjet juridik të kundërshtimit të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor për kualifikimin/skualifikimin e ofertës së operatorëve ekonomikë. Pra argumentet në thelb janë të kufizuara mbi ankesën e operatorit ekonomik.

Referuar materialeve të ndodhura në fashikullin administrativ me paraqitjen e ankesës në datën 03.02.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike me nr. 336/2026 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6303 e operatorit ekonomik “GjeoKonsult & CO” SHPK duke kundërshtuar kualifikimin e operatorit ekonomik “BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, nga ky moment interesat e operatorit ekonomik “BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, dhe nga ky moment i lind e drejta dhe detyrimi për dorëzimin e argumentave në përputhje me afatet ligjore dhe mënyrën e paraqitjes së tyre, të parashikuar në nenin 113 të LPP-së. Në rastin konkret duke qënë se procedura e prokurimit është mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik..

Referuar materialeve të fashikullit administrativ, rezulton, se në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit 336/1 prot., datë 04.02.2026, rrjedhimisht afati i fundit për dorëzimin e argumentave në Sistemin e Ankesave Elektronike nga operatori ekonomik BOE

“InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk ishte data 11.02.2026. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se me argumentat e dorëzuar nga ankimesi në KPP dhe autoritet kontraktor nëpërmjet shërbimit postar, ky i fundit nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e rrugës ligjore, për paraqitjen e argumentave sipas parashikimeve të nenit 113, pika 1 i ligjit 162/2020, “Për prokurimin publik” i ndryshuar Argumentat e dorëzuara nga ky i fundit në datë 09.02.2026 nëpërmjet shërbimit postar do të konsiderohen të padorëzuara Rrjedhimisht, referuar nenit 113 i cili parashikon se nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurim ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk nuk do të merret në shqyrtim nga Komisioni, pasi argumentat janë dorëzuar jo në mënyrën e përcaktuar në nenin 113 të LPP, duke mos përmbushur në këtë mënyrë kushtet formale për paraqitjen e argumentave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Akoma më tej, argumentet e paraqitura nga operatori ekonomik i interesuar BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk nuk janë paraqitur sipas formularit standart të përcaktuar në dokumentat e tenderit. Refderuar Vendimit nr.10, datë 23.09.2024 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Për miratimin e dokumentave standarte të tenderit për mallra, punë, shërbime për procedurën e prokurimit ”E hapur”, në shtojcën 23 të DT është përcaktuar formati i formularit të paraqitjes së argumentave nga operatorët ekonomikë të interesuar pranë autoritetit/entit kontraktor dhe komisionit të prokurimit publik. Rezulton se nga shqyrtimi i dokumentit me nr. 336/2 prot., datë 09.02.2026, të protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, subjekti i interesuar BOE “InfraKonsult” SHPK (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, me objekt: “Vënie në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik dhe Autoriteti Kontraktor”, I pretenduar nga ankimesi si formular argumentash nuk është sipoas formatit të miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, organi kompetent për hartimin dhe miratimin e tyre.

Sa më sipër pretendimet e BOE ankimes nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndtushuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

*Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

**Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “InfraKonsult” Shpk (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk, në procedurën e prokurimit “E hapur - mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. Nr. REF-70301-11-26-2025, me objekt “Projektim i objektit “Linje e re Transmetim Boville – Pika 0 me tub çeliku D=700mm; L=10km + Impiant Pastrim Infiltrimi ne Boville”, me fond limit 53,414,672.00 (pesedhjetë e tre milion e katerqind e katermbedhjetë mijë e gjashtëqind e shtatedhjetë e dy) lekë pa Tvsh, zhvilluar më datë 29.12.2025, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.a.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, objekt ankimi
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga BOE “InfraKonsult” Shpk (përfaqësues) & “ARABEL” SHPK & “Transport Highëay Consulting” SHPK & “Civil Cons” Shpk.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

